

VENDIM
Nr.180, datë 26.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.989, DATË 9.12.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË
EMERGJENCAVE CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË PËRBALLUAR
SITUATËN E SHKAKTUAR NGA PËRMBYTJET NATYRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe në vijim të vendimit nr.968, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësisë natyrore), në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.989, datë 9.12.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në shkronjën “a” të pikës 1, fjalët ... “shuma 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë...” zëvendësohet me “...shuma 696 407 923 (gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë...”.

2. Fondi shtesë sipas këtij vendimi, në vlerën 196 407 923 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë, të akordohet për:

a) këshillin e qarkut Shkodër, në vlerën 28 500 000 (njëzet e tetë milionë e pesëqind mijë) lekë, për t’u përdorur për rikonstruksionin e rrugës së Obotit.

b) bashkinë Shkodër, në vlerën 117 907 923 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë, për t’u përdorur, si më poshtë vijon:

i) 63 672 979 (gjashtëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, për rehabilitimin e KUB-it dhe rikonstruksionin e rrugëve “Qemal Draçini” dhe “Martin Camaj”.

ii) 31 234 944 (tridhjetë e një milionë e dyqind e tridhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë për rehabilitimin e KUB-it dhe rikonstruksionin e rrugës “Europa”.

iii) 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për rehabilitimin e stacionit të vjetër të pompave dhe të kabinës elektrike, në Dobraq.

iv) 8 000 000 (tetë milionë) lekë për rehabilitimin e stacionit në Bahçallëk.

c) Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në vlerën 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për t’u përdorur për blerje mallrash industriale dhe ushqimore për fazën rehabilituese.

3. Efektet financiare të këtij vendimi, në vlerën 196 407 923 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e tre) lekë, të përballohen nga KESH sh.a. (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare).

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, këshilli i qarkut Shkodër dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha